



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2060/2 Prot.

Vlorë më, 16.07.2026

VENDIM

Nr. 36, datë 16.07.2026

**PËR MOSMIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR CAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT MUJOR TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR DHËNIEN E
GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI"
VLORE**

Mbështetur në nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligjin nr. 87/2025, "Për Buxhetin e vitit 2026"; nenin 25, pika 1, shkronja q, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenin 6, pika 3, shkronja s, të Rregullores Financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Vendimin e Senatit Akademik nr. 33, datë 16.06.2026, "Për caktimin e shpërblimit mujor për anëtarët e Komisionit për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë"; si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të paraqitur me shkresën nr. 1807/2 prot., datë 01.07.2026, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 16.07.2026,

VENDOSI

1. Të mos miratojë propozimin për caktimin e masës së shpërblimit mujor për anëtarët e Komisionit për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj

Enrik Mehmeti

Elmira Kushta

Orkida Hasani

Ledina Mançka

KRYETAR

Saniela Xhaferi

Adresa /Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

